

**Kompania Porositëse:** Trans Adriatic Pipeline AG

**AAL00-ENT-000-A-TRE-0001**

**Autori:** E.ON New Build & Technology GmbH

**Rev.: 01**

**Titulli i Projektit:**  
**Trans Adriatic Pipeline – TAP**

**Titulli i Dokumentit:**

**Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG**

Rev.	Qëllimi i Çështjes	Shënim / Përshkrim	Orig.	Data
0A	Për Rishikim	Lëshimi i parë	KOE	2013-10-09
00	Për Informacion	Përfundimtar	KOE	2013-10-11
01	Për Informacion	Përfundimtar	KOE	2013-10-11

	KONTRAKTORI			KOMPANIA	
	Hartuesi	Kontrolluar	Miratuar		
Emri / Firma	Kodhelaj, Nevton	Kamberi, Zija	Schmidt, Elisabeth		
Data	2013-10-09	2013-10-09	2013-10-11		
Org. / Dept.	ENT	ENT	ENT		
Statusi i Dokumentit	<b>Paraprake</b>	<b>Kontrolluar</b>	<b>Miratuar</b>	<b>Pranuar* (Komerical)</b>	<b>Pranuar* (Teknik)</b>

 <small>Trans Adriatic Pipeline</small>		Page 2 of 11					
		<small>Kodi i Zonës</small>	<small>Kodi i Kompanisë</small>	<small>Kodi i Sistemit</small>	<small>Disc. Code</small>	<small>Lloji i Dok.</small>	<small>Nr. Serial</small>
Titulli i Projektit: <b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b> Titulli i Dokumentit: <b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>	<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04						

1	Hyrje	3
2	Përmbledhje ekzekutive	4
2.1	Përshkrimi i projektit	4
3	Çdo kufizim në kohë që është përcaktuar në Lejen Mjedisore. Qëllimi dhe metodologjia e projektit	7
3.1	Përshkrim i përgjithshëm i projektit	7
3.2	Standardet, kodet dhe rregulloret e projektit	9
3.3	Statusi aktual i zhvillimit të projektit	9
3.4	Afati i detajuar i punimeve të ndërtimit	9
3.5	Afati i detajuar i aplikimeve për marrjen e lejeve të nevojshme	10
	Figura 1. Skema principiale e seksioneve të gazsjellësit	4
	Figura 2. Pamje e përgjithshme e gazsjellësit që fillon në Greqi, kalon nëpër Shqipëri, për të mbërritur në Itali	5

 Trans Adriatic Pipeline				Page 3 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial		
Titulli i Projektit:	<b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b>								
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>		<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04						

## 1 Hyrje

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) duhet të luajë një rol kryesor për të siguruar shumëllojshmërinë dhe sigurinë afatgjatë të furnizimit të Europës me energji. Ky gazsjellës do të lidhë Europën perëndimore dhe atë juglindore me burimet e reja, të bollshme, në pellgun e Kaspikut e më tej. Ai do të krijojë mundësi të reja në Korridorin Jugor të Gazit si edhe në mbarë Europën dhe do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në plotësimin e nevojave gjithnjë e në rritje të rajonit për energji, në një mënyrë të qëndrueshme dhe me kosto efektive.

Gazsjellësi TAP siguron lidhjen që mungon ndërmjet gazsjellësve kombëtarë të Turqisë dhe Italisë.

Gazsjellësi fillon në kufirin grek/turk, pranë Kipoi-t, në skajin më të largët verilindor të Greqisë. Ai do të kalojë përmes Greqisë veriore dhe do të hyjë në Shqipëri në lindje të Korçës. Gazsjellësi do të vazhdojë përmes Shqipërisë dhe do të mbërrijë në bregdetin e Adriatikut, pranë qytetit të Fierit. Seksioni i gazsjellësit në det do të kalojë nga Fieri për në Leçe të Italisë. Gazsjellësi do të kalojë detin Adriatik dhe do të përfundojë në terminalin e pritjes së gazsjellësit (TPG) pranë Leçes në Itali, ku do të bashkohet me rrjetin Snam Rete Gas (SRG). Gjatësia e përgjithshme do të jetë rreth 871 km, përfshirë këtu seksionin në det prej 105 km.

 		Page 4 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	Trans Adriatic Pipeline – TAP					<b>AA00-ENT-000-A-TRE-001</b> Rev.: 04	
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>						




Figura 1. Skema principiale e seksioneve të gazsjellësit

## 2 Përmbledhje ekzekutive

### 2.1 Përshkrimi i projektit

Përzgjedhja e diametrit të gazsjellësit prej 48" për seksionin në tokë dhe 36" për seksionin në det, si dhe blloku i kompresorëve me turbina 15 MW, për fazën e 10 MMKV-ve, siguron një fleksibilitet të lartë të sistemit për prurjet e gazit nën 10 MMKV. Ky konfigurim i sistemit krijon mundësi gjithashtu për rrjedhën në drejtimin e kundërt deri 3 MMKV në maksimum, me kusht që presioni në hyrje për sistemin TAP, në pikën e lidhjes në Itali, nuk do të jetë nën 25 barg. Sistemi i gazsjellësit TAP është projektuar me presion 95 barg për seksionin në tokë dhe 145 barg për seksionin në det. Prurja maksimale prej 20 MMKV mund të arrihet me faza, duke instaluar kompresorë shtesë në stacionet e kompresorëve të instaluar për rastin e transportit të 10 MMKV-ve ose duke ndërtuar stacione shtesë kompresorësh, siç përshkruhet më në detaje më poshtë.

 		Page 5 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	<b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b>					<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04	
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>						

Kjo siguron gjithashtu një nivel të lartë fleksibiliteti të sistemit për prurjet e gazit nga 10 deri në 20 MMKV.

Stacionet e kompresorëve janë projektuar me module të veçanta dhe vetëm modulet që kërkohen për fazën e 10 MMKV-ve do të ndërtohen përpara se gazsjellësi të fillojë nga puna në 2019-ën. Nga ana tjetër, procesi i VNMS-së (Vlerësimi të Ndikimit Mjedisor dhe Social) është kryer për pajisjet që kërkohen për rastin e transportit të 20 MMKV-ve.

Me qëllim që të plotësohen kërkesat e Rregullores së Sigurisë së Furnizimit, në *projekt është* parashikuar që të realizohet rrjedha fizike në drejtimin e kundërt. Në këtë mënyrë, në situata të planifikuara ose emergjence, do të jetë i mundur transmetimi i gazit nga Italia për në Shqipëri dhe në Greqi.




Figura 2. Pamje e përgjithshme e gazsjellësit që fillon në Greqi, kalon nëpër Shqipëri, për të mbërritur në Itali

Gjurma e gazsjellësit është përcaktuar nga vija e mesit. Në kuadër të VNMS-së, për ndikimet mjedisore është marrë në konsideratë një korridor ndikimi prej 500 m përgjatë vijës së mesit (250 m i gjerë në secilën anë), ndërsa një korridor ndikimi prej 2 km (1 km i gjerë në secilën anë) është marrë në konsideratë për ndikimet socio-ekonomike.

 Trans Adriatic Pipeline		Page 6 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	<b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b>					<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04	
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>						

Për shkak të kushteve të këqija të infrastrukturës shqiptare, nevojiten rrugë për të hyrë në zonat ku do të kryhen punime, kryesisht në zonat malore. Këto rrugë, si dhe disa rrugë rajonale dhe ura do të duhet të ndërtohen të reja ose të përmirësohen dhe ndërtimi i tyre duhet të përfundojë përpara sesa të fillojë shpërndarja e tubave në sheshet e tubave dhe ndërtimi i gazsjellësit. Në total, në Shqipëri do të ndërtohen rreth 58 km rrugë të reja dhe do të rindërtohen/rikonstruktohen 44 km rrugë ekzistuese, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit të gazsjellësit.

Përveç këtyre do ndërtohen edhe rreth 20 km rrugë të reja (kryesisht si pjesë e rripit të punimeve në Potom) dhe do të rindërtohen/rikonstruktohen edhe 44 km rrugë, ndërsa 28 km rrugë do të riparohen me qëllim sigurimin e kalimit për në rripin e punimeve gjatë fazës së ndërtimit të gazsjellësit.

Për fazën e parë të projektit (10 MMKV) kompresorët do të vendosen në dy vende, domethënë në stacionin kryesor të kompresorëve pranë Kipoi-t (SKG00), rreth 3 km larg nga kufiri turk / grek dhe në Fier, pranë bregdetit shqiptar (SKSH03). Në këtë stacion kompresorësh presioni do të rritet përpara se gazi të hyjë në seksionin e gazsjellësit në det. Një terminal për pritjen e gazsjellësit (TPG) do të ngrihet pranë Leçes në Itali. Në fazën e parë, Stacioni i Kompresorëve SKSH02 në Bilisht, në Shqipëri, pranë kufirit grek / shqiptar do të shërbejë vetëm si një stacion filtrimi / ndarjeje, matjeje dhe për lëshimin / pritjen e pastruesit. Vendosja e tubave në këtë stacion do të mundësojë instalimin e kompresorëve për transportin e 20 MMKV-ve gjatë fazës së dytë.

Për fazën e parë tre kompresorë 15 MW, që vihen në punë me anë të turbinave me gaz, do të instalohen në secilin prej stacioneve të kompresorëve SKG00 dhe SKSH03. Dy prej kompresorëve do të jenë në punë dhe një i tretë do të jetë në gatishmëri.

Një stacion shtesë kompresorësh, që kërkohet për fazën e dytë, do të ngrihet pranë Serres (SKG01) në Greqi. Në fazën e parë atje do të instalohet vetëm një stacion valvulash të bllokimit si dhe pajisje të pastrimit të tubacionit. I gjithë projekti për stacionin e ardhshëm të kompresorëve SKG01 do të sigurohet gjatë fazës së parë.

Praktika optimale e projektimit dhe standardet e larta të cilësisë përbëjnë bazën e zbatimit të projektit TAP. Kjo përfshin gjithashtu organizimin e punës në kantier, aspektet e shëndetit, të sigurisë dhe të mjedisit (SHSM) si dhe kontrollin e cilësisë deri në dhënien e autorizimit dhe fillimin e punës.

 Trans Adriatic Pipeline		Page 7 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	Trans Adriatic Pipeline – TAP					<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04	
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>						

### 3 Çdo kufizim në kohë që është përcaktuar në Lejen Mjedisore. Qëllimi dhe metodologjia e projektit

#### 3.1 Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti TAP përfshin planifikimin, përpunimin, ndërtimin dhe dhënien e autorizimit për funksionimin e gazsjellësit dhe të mjedisëve të lidhura me të (përfshirë stacionet e kompresorëve, stacionet e matjes, terminalin e pritjes së gazsjellësit, stacionet e valvulave të bllokimit dhe dy stacione të daljes në det) për transportin e gazit natyror të thatë nga pika e lidhjes pranë Kipoi-t në kufirin greko / turk deri në juglindje të Italisë. Gazsjellësi do të kalojë përmes Greqisë, Shqipërisë, detit Adriatik dhe do të arrijë te zona e daljes në det, në provincën italiane të Leçes. Nga zona e daljes në det, gazsjellësi do të drejtohet për tek TPG-ja, ku do të bashkohet me rrjetin italian të gazit (rrjetin Snam Rete Gas).

Të dhënat bazë të projektit për gazsjellësin janë si vijon:

- Seksioni i gazsjellësit në tokë – PNT (diametri nominal i tubacionit) prej 48” dhe presioni i projektuar prej 95 bar(g)
- Seksioni i gazsjellësit në det dhe seksioni i gazsjellësit në tokë për tek TPG – PNT prej 36” dhe presioni i projektuar prej 145 bar(g)

Projekti do të zbatohet në dy faza. Faza e parë parashikon një kapacitet të gazsjellësit për transportin e 10 MMKV-ve. Në fazën e dytë kapaciteti do të rritet deri në 20 MMKV. Ky shtim i kapacitetit nuk është planifikuar aktualisht deri dhjetë vjet pas fillimit të funksionimit të gazsjellësit.

Kapaciteti i disponueshëm sipas fazave do të jetë:

- Faza 1: 10 MMKV
- Faza 2: 20 MMKV

Sistemi i gazsjellësit duke filluar nga lindja drejt perëndimit, përbëhet nga seksionet/stacionet e mëposhtme:

**Pika e fillimit:** pk 0 e gazsjellësit në kufirin grek / turk (lumi Evros) pranë Kipoi-t

- Seksioni rreth 3 km nga rrjeti TANAP (Gazsjellësi Trans-Anatolian), i lidhur me stacionin e kompresorëve SKG00, në Kipoi



 Trans Adriatic Pipeline		Page 8 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	Trans Adriatic Pipeline – TAP					<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04	
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>						

- Stacioni i kompresorëve SKG00, në Kipoi (stacioni kryesor për gazsjellësin TAP), përfshirë lëshuesin e pastruesit rreth pk 3
- Seksioni i gazsjellësit me diametër 48” dhe me gjatësi 277 km nga Kipoi në Serres SKG01 (për rastin e transportit të 10 MMKV-ve do të instalohen vetëm pajisjet e pastrimit të tubacionit; për rastin e transportit të 20 MMKV-ve do të shtohen aparaturat e kompresorëve)
- Seksioni i gazsjellësit me diametër 48” dhe me gjatësi 267 km nga SKG01 në Serres deri në kufirin grek / shqiptar
- Pika e kalimit të kufirit grek / shqiptar pranë Mesopotamisë (në anën greke)
- Seksioni i gazsjellësit me diametër 48” dhe me gjatësi rreth 5 km ndërmjet kufirit grek / shqiptar dhe SKSH02 pranë Bilishtit (për rastin e transportit të 10 MMKV-ve të vetmet pajisje që do të instalohen do të jenë pajisjet e matjes së prurjes për qëllime fiskale dhe pajisjet e pastrimit të tubacionit; për rastin e transportit të 20 MMKV-ve do të shtohen aparaturat e kompresorëve)
- Seksioni i gazsjellësit me diametër 48” dhe me gjatësi rreth 200 km në Shqipëri ndërmjet SKSH02 dhe SKSH03
- Stacioni i kompresorëve SKSH03, pranë qytetit të Fierit në Shqipëri, përfshirë pajisjet e pastrimit të tubacionit
- 30 stacione të valvulave të bllokimit me diametër të tubacionit 48”, në Greqi dhe në Shqipëri ndërmjet SGK00 dhe SKSH03 (në përgjithësi të instaluara në distancë prej 20 – 30 km ndërmjet tyre)
- 1 stacion valvulash me diametër të tubacionit 36”, në zonën e daljes në det në Shqipëri ndërmjet SKSH03 dhe zonës së daljes në det në Shqipëri
- Seksioni i gazsjellësit me diametër 36” dhe me gjatësi rreth 119 km, ndërmjet SKSH03 dhe Terminalit Italian të Pritjes së Gazsjellësit TIPG01, që shtrihet përmes detit Adriatik me një gjatësi rreth 105 km
- 1 stacion valvulash me diametër të tubacionit 36”, në zonën e daljes në det në Itali ndërmjet zonës së daljes në det në Itali dhe TIPG01
- Stacioni i kombinuar i reduktimit të presionit, matjes dhe pastrimit, TIPG01, në juglindje të Leçes, pranë seksionit të daljes në det të gazsjellësit
- Kabllot me fibra optike, që shtrihen paralelisht me të gjithë sistemin e gazsjellësit, nga SKG00 deri në TPG

**Pika e përfundimit:** pika e lidhjes me rrjetin SRG, që ndodhet në murin rrethues të TIPG01



 Trans Adriatic Pipeline			Page 9 of 11					
			Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial
Titulli i Projektit:	Trans Adriatic Pipeline – TAP		<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04					
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>							

Dy pika të daljes së gazit janë planifikuar në Shqipëri (në Korçë dhe në Fier). Vendndodhje e tyre ende mbetet për tu përcaktuar.

### 3.2 Standardet, kodet dhe rregulloret e projektit

Të gjitha impiantet dhe pajisjet do të projektohen, prodhohen, transportohen dhe do të instalohen në përputhje me seksionet përkatëse të kodeve, standardeve dhe rregulloreve europiane, kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, do të zbatohen rregulloret dhe ligjet përkatëse kombëtare të vendeve tranzit.

### 3.3 Statusi aktual i zhvillimit të projektit

TAP AG do ti delegojë detyrat e hartimit të projektit në fazën (FEED) drejt dy operatorëve të shërbimeve teknike:

- Ofruesi i Shërbimit Teknik-Lindje (TSPE) dhe
- Ofruesi i Shërbimit Teknik-Perëndim (TSPW).

TSPW do të jetë përgjegjës për zhvillimin e projektit në seksionin detar të tij, ndërsa TSPE do të jetë përgjegjës për seksionin tokësor të gazsjellësit si edhe për vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemit.

Aktualisht të dy kompanitë janë duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për hapjen e tenderit për kompanitë e ndërtimit. Kontratat për fazën e ndërtimit do të jenë të llojit EPC (Engineering Procurement Contract). Afati i parashikuar për këtë qëllim është Janari i vitit 2015. Projektet e mëpasshme do të bëhen nga kontarktori EPC. Kjo është arsyeja që dokumentat e paraqitura në këtë document pasqyrojnë statusin aktual, por që mund të ndryshohet sërish prej tij në fazat e mëvonshme. Dokumentacioni i nevojshëm për fazat e mëvonshme gjatëpajisjes me Lejen Komplekse Zhvillimore do të përgatiten nga EPC.

Afatet e parashikuar për aplikim të cilët janë paraqitur në kreun 3.5 të këtij materiali mund të ndryshojnë si rrjedhojë e kërkesave të KKT apo optimizimit të afateve të paraqitura në kreun 3. 4.

### 3.4 Afati i detajuar i punimeve të ndërtimit

Afati i detajuar i punimeve të ndërtimit të gazsjellësit TAP, në territorin Shqiptar parashikon që ato të realizohen sipas datave të paraqitura në vijim:

- Paketa e rrugëve të kalimit/hyrëse (të reja dhe të riparuar) fillon në Tremujorin e dytë ose të tretë 2014;
- Ndërtimi i bazave të tubave dhe kampeve të punës fillon në Tremujorin e tretë 2015;
- Paketa e tretë e rrugëve të kalimit/hyrëse (nga kontraktori i ndërtimit EPC) fillon në Tremujorin e tretë 2015;

 Trans Adriatic Pipeline				Page 10 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial		
Titulli i Projektit: <b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b>		<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04							
Titulli i Dokumentit: <b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>									

- Ndërtimi i seksionit tokësor të gazsjellësit fillon në Tremujorin e katërt 2015;
- Ndërtimi i seksionit detar të gazsjellësit fillon në Tremujorin e parë 2016;
- Ndërtimi i stacioneve të kompresorëve/matjes fillon në Tremujorin e dytë 2016.

### 3.5 Afati i detajuar i aplikimeve për marrjen e lejeve të nevojshme

Kuadri legjislativ për një projekt kaq të madh si Projekti TAP është hartuar në bashkëpunim me qeverinë / autoritetet shqiptare. Këto zhvillime kanë ndryshuar kontekstin legjislativ, me të cilin ndeshet tani Projekti TAP. Kuadri legjislativ u hartua në formën e tij konceptuale si draft dhe u plotësua më pas në formën e cila përfshin të gjitha këto zhvillime legjislative dhe siguron një metodologji të detajuar për secilën leje të domosdoshme për Projektin.

Zhvillimi më i rëndësishëm në legjislacionin e ndërtimit ka të bëjë me ndryshimet që ka pësuar së fundmi Ligji i Planifikimit të Territorit, në të cilin u përfshi një terminologji e re për lejet e ndërtimit. Si rrjedhim, tani Shoqëria e gazsjellësit TAP duhet të aplikojë për një Leje Zhvillimore Komplekse, e cila përbën dokumentin teknik dhe administrativ, që lejon ndërtimin e projekteve të përmasave kaq të mëdha, siç është TAP.

Kjo leje do të jepet në dy faza. Në fazën e parë, aplikimi do t'i paraqitet MEI, e cila do t'ia përcjellë atë AKPT-së, dhe më pas te KKT-ja, e cila është përgjegjëse për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për gjithë Projektin TAP, bazuar në projektet konceptuale dhe verifikimet në vend lidhur me tokat që do të preken nga TAP-AG.

Në fazën e parë të aplikimit, për të gjitha pjesë përbërëse të projektit (përfshirë rrugët e kalimit/hyrëse, stacionet e kompresorëve/matjes dhe gazsjellësi në të dyja seksionet e tij: Tokë dhe Det, sheshet e punës dhe bazat e tubave) i cili do të dorëzohet pranë MEI, dosja do të përmbajë:

- Projekt idenë e zhvillimit dhe skicën e plotë të projektit (gjurmën e strukturës) të shoqëruar me parametrat më të rëndësishëm dhe zonat konkrete ku do të jenë kantieret e ndërtimit dhe ato ku do të ndërkyhet;
- Informacion mbi marrëdhëniet e pronësisë dhe përdorimit të tokës për sipërfaqet ku do të kalojë projekti;
- Afatet e fazave të zhvillimit në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 116/2013 dhe marrëveshjes së lidhur midis TAP-AG dhe Qeverisë së Vendit Pritës (HGA);
- Llogaritjet paraprake dhe afatet e pagesës së taksave të infrastrukturës, në përputhje të plotë me fazat e zhvillimit të rprojektit;
- Leja Mjedisore.

 Trans Adriatic Pipeline				Page 11 of 11					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompanisë	Kodi i Sistemit	Disc. Code	Lloji i Dok.	Nr. Serial		
Titulli i Projektit:	<b>Trans Adriatic Pipeline – TAP</b>								
Titulli i Dokumentit:	<b>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit TAP-AG</b>		<b>AAL00-ENT-000-A-TRE-0001</b> Rev.: 04						

Aprovimi i Lejes Komplekse Zhvillimore do të bëhet nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), por do të lëshohet nga MEI në mënyrë progressive në përputhje me fazat e zhvillimit të projektit TAP-AG. Dokumentat administrative të Lejes Komplekse Zhvillimore do të lëshohen nga MEI në plotësim të kërkesave të TAP-AG por edhe të plotësimit prej tij të kërkesave të parashikuara në ligjin 10119, datë 23 Prill 2009 “Ligji mbi planifikimin e territorit” të rishikuar si edhe legjislacionit ndihmës Nr. 116/2013. Megjithatë, leja nuk do të jepet nëse Shoqëria e gazsjellësit TAP nuk paraqet Projektin e detajuar për secilin aktivitet ndërtimi (rrugët hyrëse, seksioni i gazsjellësit në tokë, stacionet, seksioni i gazsjellësit në det) dhe gjithë dokumentacionin tjetër përkatës (miratimet paraprake) në fazën e dytë. Projekti i detajuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që shoqërojnë atë mund të paraqiten veçmas për secilin aktivitet ndërtimi dhe leja do të jepet për atë komponent specifik të Projektit vetëm nga MEI, pa ndërhyrje nga AKPT-ja ose KKT-ja.

- Etapa e dytë e aplikimit, do të përmbajë dhe do të bëhet si vijon:
- Dy paketa për rrugët e kalimit/hyrëse (tremujori i parë ose i dytë, 2014);
- Ndërtimi i bazave të tubave dhe kampeve të punës (tremujori i katërt 2014);
- Paketa e tretë për rrugët e kalimit/hyrëse (nga kompania kontraktore e ndërtimit, tremujori i dytë 2015);
- Seksioni tokësor i gazsjellësit (tremujori i dytë 2015);
- Seksioni detar i gazsjellësit (tremujori i katërt 2014 ose tremujori i parë 2015);
- Ndërtimi i stacioneve të kompresorëve/matjes (tremujori i katërt 2015).

TAP-AG dëshiron të rezervojë të drejtën e kombinimit të paketave me njëra-tjetrën me qëllim optimizimin e procesit të zhvillimit të projektit.